



Informationsverbund
ASYL & MIGRATION


Die Anhörung im Asylverfahren – albanische Übersetzung

Intervista në periudhën e kërkesës së azilit

Shënime për azilkërkuesit në Gjermani

Botimi i tretë, 2015

Kjo broshurë ju është dorëzuar nga:



In Kooperation mit



Parathënie e kësaj broshurës

Me këto shënime duam t'iu ofrojmë disa këshilla që ju shërbejnë për intervistën e kërkesës për azil. Intervista është pjesa më e rëndësishme, për të treguar shkaqet e ikjes. Kjo mund të sjellë vendimin, se a do të mbrohëni nga shteti Gjerman. Për këtë arsye duhet të përgatiteni sa më mirë për intervistën.

Me këtë broshurë mundemi t'iu ofrojmë vetëm disa shënime të përgjithshme. Më mirë do ishte para intervistës të konsultoheni me një **avokat** (Rechtsanwalt) **apo avokate** (Rechtsanwältin) ose me një **zyrë këshilluese** për refugjatë. Në Gjermani ka një numër të madh të shoqatave të panvarura, të cilat refugjatët i këshillojnë pa pagesë dhe në mënyrë të pavarur. Informacione mbi këto shoqata ju ofrohen kur dorzoni kërkesën për azil. Nëse nuk ju ofrohen, pyesni nënpunësit e shërbimeve sociale në strehimin fillestar.



Impressum


Herausgeber und ©: Informationsverbund Asyl und Migration e. V., Greifswalder Str. 4, 10405 Berlin, kontakt@asyl.net
Die erste Auflage wurde erstellt in Zusammenarbeit mit dem Info-Bus für Flüchtlinge, München.
V. i. S. d. P.: Michael Kalkmann, c/o Informationsverbund Asyl und Migration

Këtë broshurë e gjeni edhe në www.asyl.net (nënfaqja „Arbeitshilfen/Publikationen“).

Unveränderte und vollständige Vervielfältigung und Weitergabe ist gestattet.

Çfarë është kërkesa e azilit?


Një kërkesë për azil mund ta dorëzoni në zyrat e **Bundesamt für Migration und Flüchtlinge, BAMF** („Enti federal për migracion dhe refugjatë“). Nëse deklaroni para një institucioni ose shërbimi tjetër shtetëror, (p. sh. policisë) që doni të paraqisni kërkesën për azil, ju do të udhëzoheni të paraqiteni sa më shpejt në një nga zyrat e BAMF-it. Pastaj do të vendoset se cila zyrë do ta marrë përgjegjësinë për përpunimin e kërkesës suaj. Deri te këto zyrat duhet të udhëtoni. Është shumë e rëndësishme që të udhëtoni sa më të shpejtë në entin përgjegjës. Çdo vonesë e juaja mund të ketë pasoja në përpunimin e kërkesës për azil.



Fatkeqësishtë ndodhë që edhe në zyrat përgjegjëse të BAMF-it nuk pranohen menjëherë kërkesat për azil. Në këtë rast së paku duhet t'iu dorëzohet një letër e titulluar „Bescheinigung über die Meldung als Asylsuchender, BÜMA“ (Vërtetim për regjistrimin si azilkërkues) ose një letër e ngjashme. Nëse kërkesa juaj për azil nuk pranohet edhe pas disa javësh, kontaktoni një shoqatë këshilluese në procesin e kërkesës së azilit.

Kur të dorëzoni kërkesën e azilit, do të fotografoheni dhe do të regjistrohen shënjat e gishtave. Mund që këtu t'iu parashtrajnë reth 25 pyetje për personin tuaj, vendbanimin e fundit dhe prejardhjen, vendlindjen, prindërit, gjyshërit dhe udhëtimin për në Gjermani. Këto pyetje mund t'iu parashtrohen më vonë gjatë intervistës, sepse procedura nuk është e njëjtë dhe domosdoshmërisht e njëtrajtshme.

Pasi kërkesa juaj për azil të jetë regjistruar, do t'iu dorëzohet një vërtetim me titullin „Aufenthalts-gestattung“ (lejeqëndrim). Shërben si dokument identifikues dhe duhet ta mbani patjetër me vete.



Në qoftë se pas njëfarë kohe dërgoheni në një strehim tjetër, duhet patjetër ta informoni BAMF-in për adresën e re. Është e detyrueshme që patjetër të njoftoni këtë institucion. Nëse keni ndonjë avokat apo avokate informoni edhe ata së shpejti.

Për çfarë bëhet fjalë në periudhën e kërkesës së azilit?

Në periudhën e kërkesës së azilit BAMF-i verifikon këto pyetje:

- A është Gjermania përgjegjëse për kërkesën tuaj për azil? (Informacione mbi këtë gjëni në kutin e mëposhtme në këtë faqe)
- Nëse Gjermania e përpunon kërkesën tuaj për azil: A ishit në vendin e prejardhjes të përndjekur dhe çfarë mund t'iu ndodhë nëse ktheheni përsëri atje?

Vendosja e përgjegjësisë në „Proçesin e Dublinit“

Shumë shtete në Evropë, ndër ato edhe Gjermania, kanë nënshkruar marrëveshje njëra me tjetrën, që vetëm një prej tyre të marrë përgjegjësinë për përpunimin e kërkesës për azil. Për këtë çështje këto shtete kanë nënshkruar një marrëveshje në Dublin, kryeqytetin e Irlandës. Proçesi, nëpërmjet të cilit merret vendimi se cili shtet është përgjegjës për kërkesën e azilit, për këtë shkak quhet „Proçesi i Dublinit“.

Në „Proçesin e Dublinit“ mund të rezultojë, që kërkesa juaj për azil të mos përpunohet në Gjermani, por në një shtet tjetër evropian. Kjo është e mundëshme sidomos,

- nëse keni dorzuar një kërkesë për azil në një shtet tjetër evropian
- nëse jeni regjistruar nga institucionet në një shtet tjetër evropian
- nëse keni udhëtuar me një vizë të një shteti tjetër evropian
- nëse keni ndonjë lloj vërtetimi që keni qëndruar në një shtet tjetër evropian.

Ju duhet patjetër të konsultoheni me një zyrë këshilluese, me avokaten apo avokatin tuaj, nëse është e mundur, që mos të jetë Gjermania përgjegjëse për kërkesën tuaj për azil. Në këtë rast, mund të mbyllet proçesi i azilit në Gjermani, pa marrë parasysh shkaqet e kërkesës tuaj. Kjo nuk do të thotë, që nuk është e mundëshme të pranohet azili në Evropë. Prandaj ju do të detyroheni, që kërkesën tuaj për azil të dorzoni për përpunim në shtetin përgjegjës. Gjithashtu edhe atje mund t'iu ofrohet mbrojtje.

BAMF-i është i detyruar, t'iu informoj mbi „Proçesin e Dublinit“. Për këtë do t'iu dorëzoj shënime. Gjithashtu duhet të vijojë një bisedë, se çfarë është „Proçesi i Dublinit“. Kjo bisedë mund të lidhet së bashku me intervistën, te cila i tregoni shkaqet për kërkesën e azilit. Por mund edhe vijon ndarë prej intervistës. Nëse ka shkaqe të rëndësishme, përse kërkesa juaj për azil patjetër në Gjermani dhe jo në një shtet tjetër të Evropës të përpunohet, duhet në këtë bisedë të tregoni shkaqet.

Nëse në një shtet tjetër të Evropës është shqyrtuar një kërkesë e juaja për azil më parë, kjo mund të sjellë pasoja për kërkesën tuaj për azil në Gjermani. Në këto raste konsultohuni patjetër me një zyrë këshilluese.

Kontrolli, se a jeni të përndjekur në vendlindjen tuaj

Nëse kërkesa juaj për azil do të përpunohet në Gjermani, qëndrojnë në pikë të vëmendjes pyetjet, a keni qenë të përndjekur apo jeni në rrezik nëse ktheheni përsëri atje. Me fjalën përndjekje nënkuptohet: rreziku/cënim i jetës, trupit dhe lirisë. Gjithashtu kuptohet ndër përndejke edhe nëse rrezikohen të drejtat e njeriut, me pasoja të rënda për ju. Gjithashtu merren parasysh, a jeni të rrëmbyer në të drejtat e njeriut për shkak të një „shenje“. Këto mund të jenë shenjat e një njeriu (ngjyra e lekurës, gjinia, orientimi seksual), po ashtu edhe qëndrimi politik dhe fetar.

Nëse nuk vërehet një rrezik, nuk do të thotë që kontrollimi i kërkesës së azilit mbaron. BAMF-i duhet të verifikojë gjithashtu, nëse ka rreziqe tjera në shtetin tuaj. Këto janë për shembull një epidemi/sëmundje dhe rreziqe tjera. Gjithashtu merren parasysh a ka rreziqe tjera që çenojnë jetën, trupin apo lirinë, për shembull një luftë apo luftë qytetare në shtetin tuaj.

E rëndësishme është pyetja, para se të largoheni për në Gjermani, a ka pasur ndonjë vend në shtetin tuaj ku mund të kishit gjetur siguri të duhur. Kjo mund të jetë në një shtet tjetër ose në një rajon tjetër të shtetit tuaj. Nëse institucionet gjermane vërejnë që është e mundur që në një vend tjetër mund të ktheheni dhe mbroheni, në këtë rast mbrojtja në Gjermani nuk merret përsipër.

Ftesa për intervistë

Intervista është vendimtare, nëse do të ketë sukses kërkesa juaj për azil. Kjo vlenë edhe atherë, nëse ju keni treguar shkaqet e ikjes pranë institucioneve tjera (për shembull në polici) ose gjatë regjistrimit në strehimin pranues. Me rëndësi është, se çfarë thoni në intervistën e BAMF-it.

Intervista regullisht bëhet disa ditë pas dorëzimit të kërkesës për azil. Në realitet mund të zgjasë disa muaj, deri sa t'iu caktohet një takim për intervistën. Është e mundur që, BAMF-i t'iu caktojë edhe një takim tjetër, gjatë të cilit ju parashtrohen pyetje, a keni qëndruar në një shtet tjetër evropian. Në këtë pyetësor bëhet fjalë, që ndoshta një shtet tjetër evropian është përgjegjës për përpunimin e kërkesës tuaj për azil. Ky takim do të thotë i përket “Proçesit të Dublinit” (Informacione për këtë gjeni në kutinë në faqen 3). Nëse nuk jeni të sigurt, se cili takim është intervista, pyesni në një zyrë këshilluese.

„Proçesi i përsheptuar“ pa intervistë

BAMF-i mund ti pranojë si refugjatë azilkërkuesit edhe në „Proçesin e përsheptuar“, pa kryer intervistën. Kjo procedurë praktikohet nga BAMF-i për disa grupe të caktuara, të cilët është e dukshme, që do të pranohen si refugjatë. Personat, të cilët janë zgjedhur për këtë procedurë, ju dorëzohet një pyetësor dhe disa informacione të ndryshme mbi „Proçesin e përsheptuar“. Kush nuk merrë pyetësor në letër, duhet të tregojë shkaqet e kërkesës për azil në intervistë.

Nëse kërkesa juaj për azil nuk refuzohet para kohe sipas „Proçesit të Dublinit“, do të ftoheni me shkrim për „Anhörung gemäß § 25 Asylverfahrensgesetz“ (Intervistë sipas § 25 ligji për procedurën e kërkesës për azil). Nëse - për shkak të një sëmundje - nuk mundeni të shkoni në takimin e caktuar, duhet të njoftoni BAMF-in sa shpejti dhe të merrni një vërtetim nga doktori.


Në intervistë do të pyeteni personalisht nga një puntor i BAMF-it për shkaqet e ikjes. Intervista është mundësia më e rëndësishme që mund të shfrytëzoni, për të dhënë shkaqe të vlefshme për kërkesën e azilit. Duhet ta keni parasysh të mos harroni takimin e caktuar dhe të përgatiteni sa më mirë. Mos vonoheni për takimin e caktuar dhe mundoheni të jeni në kohë e caktuar prezent. Në raste të veçanta mund të zgjasë edhe më gjatë, deri sa të fillojë intervista. Përgatituni edhe merreni diçka për të ngrënë dhe ndonjë pije.

Shënime për intervistën

Mundohuni që para intervistës të mbani mend detaje më të rëndësishme të shkaqeve prej të cilave jeni larguar nga shteti juaj. Është mirë që datat më të rëndësishme dhe shkaqet e ikjes t'iu shkruani edhe në një letër. Kjo ju mundëson që të orientoheni dhe të njihni paqartësitë që mund t'iu ndodhin gjatë intervistës. Mos ia dorëzoni këto shënime BAMF-it dhe mos i merreni me vete gjatë intervistës. Kështu askush nuk do të mendojë se keni një tregim të parapërgatitur. Duhet të keni parasysh se gjatë intervistës do t'ju duhet të tregoni edhe ngjarje që për ju janë të vështira apo edhe rënda.



Nëse ju si grua nuk mundet të flisni për dhunime ose situata të rënda që keni përjetuar, ngaqë puntori i BAMF-it është burrë, ju lutemi që të tregoni sa më parë. Në BAMF ka nënpunëse femra të cilat janë të specializuara pikërisht për intervistën vetëm për femra. Gjithashtu, në BAMF ka edhe nënpunës të specializuar për komunikimin dhe intervistat me fëmijë, adoleshentë, persona që kanë sëmundje mendore dhe persona të traumatizuar. Edhe nëse jeni të përndjekur për shkak të orientimit seksual, mund të dëgjoheni në intervistë nga punëtorë të cilët janë të specializuar pikërisht për këtë.



Gjatë intervistës është një përkthyes apo përkthyesë pranishëm. Njoftoni ju lutemi sa më parë BAMF-in në cilën gjuhë doni ta bëni intervistën. Duhet të jetë një gjuhë në të cilën mund të shpjegoni rethanat tuaja sa më mirë. Edhe nëse dëshironi një përkthyesë, mund ti tregoni BAMF-it.

Përkthyesi ose përkthyesja duhet të përkthejë në detajë atë që thoni. Ai ose ajo ka për detyrë vetëm të përkthejë atë që thoni ju dhe pyetjet e puntorit të BAMF-it, dhe jo të japë informacione dhe shpjegime tjera. Nëse mendoni se përkthyesi ose përkthyesja nuk e bën këtë detyrë siç duhet ju lutemi jepni një shenjë. Nëse mendoni se ka keqkuptime të mëdha, kërkoni që intervista të bëhet me një përkthyes tjetër. Sigurisht, duhet të lejoni që kritika dhe dyshimi juaj të protokollohen.



Nëse keni ndonjë **dëshmi me shkrim** nga kush jeni të përndjekur, tregoni këto dokumente, në rastin më të vonë para intervistës. Këto dokumente mund të jenë (p. sh. Dokuemnte institucionale, fletëvërtetim nga partia politike, organizatë religjioze etj.) artikuj të ndonjë gazete për ndonjë ngjarje, e cila ju ka prekur edhe juve. BAMF-i i shton këto dukumente në dosjen tuaj. Kërkoni që BAMF-i t'iu bëjë një kopje të dokumentave. Nëse mendoni se shoqëria ose familja mund t'iu dërgojnë ndonjë dokument nga vendi nga keni ikur, njoftoni për këtë BAMF-in. Dokumentet mund të jenë shumë të vlefshme si dëshmi. E rëndësishme është prapëseprapë se çfarë thoni në intervistë. Mos dërgoni dokumenta të falsifikuara. Këto dallohen gati çdoher dhe rezultojnë në pavlefshmërinë e gjithë deklaratave tuaja.

Nëse keni dokumente që dëshmojnë fluturimin për në Gjermani (p.sh. biletën e fluturimit ose boarding card) dorëzoni këto në BAMF.



Është e mundur që një „**person i afërt**“ t'iu përcjellë gjatë intervistës. Mund të jetë një shoqe, apo shok, një këshillues apo këshilluese. Si rregull nuk është e mundur që t'iu përcjellë një familjar i cili gjithashtu ka dorëzuar një kërkesë për azil. Nëse doni ta përdoreni këtë shërbim, njoftoni BAMF-in sa më parë. Do të ishte shumë mirë nëse personi juaj shumë i afërt flet gjuhën gjermane dhe gjuhën shqipe. Ky person i afërm nuk mundet të prezantoj shkaqet e juaja vetvetiu.

Vijimi i intervistës

Intervista si regullisht fillon me 25 pyetje. Këtu bëhet fjalë për të dhënat personale, çdo gjë që bëhet fjalë për personit tuaj – ndër këto për bashkshortin ose bashkshorten tuaj, fëmijët, prindët dhe profesionin – gjithashtu edhe udhëtimi juaj. Nëse këto pyetje janë parashtruar më parë gjatë regjistrimit, atëherë nënpunësit e BAMF-it do të pyesin vetëm shkurtimisht për ktë.

Pastaj ju jepet mundësia të deklaroni sa më saktë shkaqet e ikjes. Ju duhet sa më **qartë dhe në detajë të shpjegoni** përndjekjen dhe rreziqet që ju kanoseshin nga përndjekja që ju është bërë ndaj juve (burgosje, keqtrajtim, përdhunim etj.) dhe shkaqe të tjera që përshkruajnë ikjen tuaj. Me një përshkrim të saktë të rrethanave në të cilat gjendeni, rritet mundësia që punëtorët e BAMF-it t'iu besojnë. Përshkruani nga çfarë keni frikë nëse ktheheni në vendlindje. Mos përshkruani situatën politike, vetëm në rast se ju parashtrohet pyetja.

Ju lutemi mos i përshkruani ngjarjet tërthorazi (si për shembull, „familja ime ka pasur problem me policinë“) por përgjigjuni saktë çfarë ka ndodhur. Si ndihmë mund ti përdoreni këto pyetje:

- „Çfarë ka ndodhur dhe si ka ndodhur?“
- „Kur dhe ku ka ndodhur?“
- „Pse ka ndodhur?“

Edhe nëse kërkohet një përshkrim i saktë, nuk do të thotë, që duhet t'iu rikojtohen gjitha detajet ose secilës pyetje t'ia gjeni një përgjigje. Për shembull, është normale, që nuk ju kujtohet data e një ngjarjeje të kaluar para një kohe të gjatë. Në këtë rast nuk duhet të qëlloni datën e saktë ose ta shpikni nga mendja një datë. Kjo mund të bjerë në kundërshtim me ndonjë thënie të juaja. Thoni më mirë, që nuk ju kujtohet data e saktë dhe mundoheni, që ta përkufizoni me ndihmën e datave të tjera (si p. sh.: „diku afër dy javë para ditëlindjes të babait tim“ ose „duhet të kishte qenë dimër, se isha veshur trashë“).

Në rethin e azilkërkuesve shpeshherë fliten „llafe“ dhe „histori“ me të cilat thuhet se pranohet kërkesa e azilit të BAMF-i. Mos ju besoni këtyre dhe mos lejoni që të kenë influencë në ju. Puntorët e BAMF-it e dinë situatën në vendlindjen tuaj dhe i dallojnë informacionet e rrejshme. Në këtë rast, ka mundësi që pastaj të mos besojnë as informacionet tjera të vërteta që i keni dhënë.

Ka mundësi që puntorët e BAMF-it të parashtrojnë pyetje për disa pika të caktuara përsëri. Prandaj ju nuk duhet të përgjigjeni sa më shkurtë këtyre pyetjeve, por duhet të prezantoni të gjitha pikat e rëndësishme sa më gjërë, edhe nëse nuk jeni pyetur sakt për atë. Përgjigjuni çdoherë pasi të keni kuptuar plotësisht pyetjen. Nëse nuk e kuptoni pyetjen plotësisht, pyesni edhe njëherë çfarë ishte pyetja e saktë.

Nëse vuani nga ndonjë sëmundje, duhet ti tregoni BAMF-it, sidomos nëse vini nga një shtet që nuk ka sistem funksional shëndetsor ose nëse nuk mundet të paguani shpenzimet e shërimit.


Mos u ngutni. Merrni aq kohë sa ju duhet. Në raste të vështira mund ta ndërprisni intervistën dhe të bëni një pushim ose të vazhdoni në një ditë tjetër.

Protokolli

Nënpunësit e BAMF-it e përmbledhin gjithë procedurën intervistës dhe përgjigjet e juaja në një protokoll. Përmbajtjen e protokollit gjithashtu e diktojnë në një inçizim, i cili më vonë kalon në letër.

Protokolli duhet t'iu përkthehet juve fjalë për fjalë. Kjo ndodh si rregull gjatë intervistës pjesë-pjesë. Nëse gjeni ndonjë gabim ose keqkuptim, kërkoni që ato të përmirësohen dhe të korrigjohen. Protokolli është dokumenti më i rëndësishëm në kërkesën e azilit. Keni kujdes që nga gabimet në protokoll mund të lindin mosmarveshje dhe mosbesim.

Më në fund do t'ju kërkohet të nënshkruani/firmoseni që e keni pasur mundësinë të tregoni informacionet më të rëndësishme, që nuk ka pasur keqkuptime dhe protokollin ju është përkthyer prapë. Nënshkruani/firmosni vetëm nëse nuk keni ndonjë vërejtje për procesin e intervistës. Mos nënshkruani nëse nuk jeni dakord me përkthysin ose nuk pajtoheni me protokollin. Në raste të tilla duhet të kontaktoni një zyrë këshilluese për procesin e azilit, një avokat apo avokate për dyshimet tuaja.



Kërkoni që një kopje e protokollit t'iu dorëzohet ose t'iu dërgohet para se të merret vendimi i BAMF-it. Si rregull ju dërgohet protokollin pas disa javësh me postë. Nëse keni angazhuar një avokat apo avokate, do të dërgohet atje protokollin dhe pastaj do t'iu dërgohet juve ose do të bisedoni për këtë. Kontrolloni edhe njëherë dhe tregoni avokates apo avokatit për gabimet që mund t'iu gjeni. Nëse nuk keni avokat apo avokate, kërkoni ndihmë në një zyrë këshilluese, që të përmirësojnë gabimet në BAMF.

Vendimi i BAMF-it

Vendimi („Bescheid“) i BAMF-it për kërkesën tuaj për azil do të vijë me postë. Për këtë arsye pas intervistës, duhet të kontrolloni çdo ditë, nëse ka postë për ju. Nëse në strehinimit të përkohshëm, në të cilin ndodheni, ka një kuti për postën e posaçdhur, kontrolloni çdo ditë. Nëse ju keni një avokat apo avokate, atherë BAMF-i mund t’ua dërgoj vendimin në zyrën e avokatit. Sigurohuni që avokati apo avokatja juaj të ketë mundësi t’iu kontaktojë në çdo kohë.



Nëse ju vjen përgjigja negative, është e drejta juaj dhe keni mundësinë të kundërshtoni në gjykatë. Për këtë keni shumë pak kohë. Kini kujdes se çfarë shkruan në faqen e parë të vendimit:

- Nëse në faqen e parë shkruan, „Der Antrag auf Asylanerkennung wird abgelehnt“, (‘‘Kërkesa për azil nuk pranohet’’), keni si regullisht dy javë kohë, që të kundërshtoni në gjykatë.
- Në shumicën e rasteve shkruan në faqen e parë të vendimit „Der Antrag auf Asylanerkennung wird als **offensichtlich unbegründet** abgelehnt“, (‘‘Kërkesa për azil nuk pranohet për shkak që është dukshëm pabazë’’). Në këtë rast keni vetëm një javë kohë, që të kundërshtoni me shkrim në gjykatë.
- Nëse në faqen e parë të vendimit shkruan „Der Antrag auf Asylanerkennung wird als **unzulässig** abgelehnt“, (‘‘Kërkesa juaj për azil refuzohet si e papranueshme’’), BAMF-i ka marrë vendimin sipas ‘‘Proçesit të Dublinit’’ dhe është i mendimit, që një shtetë tjetër evropian duhet të përpunojë kërkesën tuaj për azil. Në këtë rast ju do të udhëzoheni që të dërgoni kërkesën tuaj për azil në atë shtet. Edhe në këtë rast keni vetëm një javë kohë, që të kundërshtoni me shkrim në gjykatë.

Sidoqoftë duhet patjetër të kontaktoni avokatin apo avokaten tuaj ose një zyre këshilluese po në të njejtën ditë.

